



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.828 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan, në të cilën ka pretenduar se në bazë të nenit 25 të Rregullës nr.09/2013 ky subjekt politik në afat ligjor ka parashtruar ankesë lidhur me Qendrën e Vendvotimit (QV), 0402D/07R. Në këtë VV kanë votuar 501 votues, ku në raportin e KQZ i rritet vota kandidatit të LDK nga 206 në 260 vota, ndërsa kandidati i PDK-së ka pasur 131 vota kurse figurojnë 106. Dy komisionerët e këtij subjekti politik këtë manipulim e kanë zbuluar pas shpalljes së rezultateve në KQZ, prandaj kërkohet rinumërimi i votave në këtë Qendër të Vendvotimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 828/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.